INSTAT

SHQIPËRIA NË SHIFRA

SHQIPËRIA NË SHIFRA 2017

Drejtor botimi: **Delina Ibrahimaj**
Përpunimi Statistikor: **INSTAT**

Punoi/Prepared: INSTAT

© Copyright INSTAT 2018

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij
në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim
të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Bul. "Zhan D'Ark" , Nr.3, Tiranë / Albania
Tel: + 355 4 2222411 / 2233356
Fax: + 355 4 2228300
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

PËRMBAJTJA
INSTAT

Popullsia	4
Buxheti i Familjeve	6
Shëndetësia	8
Statistikat e Krimeve	11
Arsimi dhe Njohuritë	14
Kultura	16
Tregu i Punës	17
Çmimet	20
Llogaritë Kombëtare	21
Regjistri i Ndërmarrjeve	23
Tregtia e Jashtme	24
Teknologjia e Informacionit dhe Komunikacionit	25
Mjedisi, Mbetjet	26
Mjedisi	27
Peshkimi	28
Mjedisi, Biodiversitet	29
Bujqësia, Pyjet	30
Transporti	31
Turizmi	32

LINDJET, VDEKJET DHE MIGRACIONI NETO



POPULLSIA MË 1 JANAR SIPAS GRUPMOSHAVE



INDEKSI SINTETIK I FEKONDITETIT
Numri mesatar i fëmijëve që një grua mund të lindë gjatë periudhës së saj riprodhuese 15-49 vjeç.
JETËGJATËSIA MESATARE NË LINDJE
Numri mesatar i viteve që një i lindur sot pritet të jetojë

Popullsia e Shqipërisë në 1 Janar 2018, rezultoi 2,87 milionë duke pësuar rënie prej 0,2 %, krahasuar me një vit më parë. Gjatë vitit 2017, kanë lindur rreth 31 mijë foshnje, ndërsa kanë vdekur rreth 22 mijë persona. Numri i lindjeve vazhdon të tejkalojë numrin e vdekjeve, pavarësisht se diferenca midis tyre po ngushtohet me kalimin e viteve. Kjo diferencë në vitin 2017 është rreth 9 mijë. Nga ana tjetër, migracioni neto vazhdon të mbetet negativ (diferenca midis imigrantëve dhe emigrantëve), duke rezultuar rreth 15 mijë në 2017.
Të moshuarit në Shqipëri paraqesin tendencë në rritje nga viti në vit.
Në 1 Janar të 2018, grupmosha 60-79 vjeç zë 17,1 % nga 16,5 % të popullsisë gjithsej në 1 Janar të 2017. Tendencë në rritje shfaq edhe grupmosha mbi 80 vjeç.
Grupmosha 0-14 vjeç paraqet tendencë në rënie, duke zënë 17,7 % në 1 Janar të vitit 2018, krahasuar me 18,2 % që zinte në 1 Janar të vitit 2017.
Ulja e numrit të të rinjve dhe rritja e numrit të të moshuarve, vjen si pasojë e uljes së lindshmërisë dhe rritjes së jetëgjatësisë.

Në 1 Janar 2018, Tirana zë 30,8 % të popullsisë gjithsej, duke vazhduar të jetë një nga qarqet më të populluara të vendit, ndjekur nga Fieri (10,4 %), Durrësi (10,1 %) dhe Elbasani (9,7 %). Vetëm 3 qarqe pësuan rritje të popullsisë në

A e dini se?

Amelia dhe Noel janë emrat më popullor për të sapolindurut gjatë vitit 2017.

POPULLSIA

1 Janar 2018 në krahasim me një vit më parë, përkatësisht Tirana, Durrësi dhe Vlora. Të gjitha qarqet e tjera pësuan një tkurrje të numrit të popullsisë gjatë 2011-2017 dhe kjo vjen kryesisht si pasojë e lëvizjeve të brendshme, drejtuar në qendrat urbane, kryesisht në Tiranë, në Durrës dhe në Vlorë.
Qarku i Gjirokastrës paraqet numrin më të ulët të popullsisë me rreth 63 mijë banorë dhe zë në 1 Janar të 2018 vetëm 2,2 % të popullsisë gjithsej, ndjekur nga qarku i Kukësit i cili zë 2,7 %.

Në vitin 2017, jetëgjatësia për femrat është 80,0 vjet dhe për meshkujt 77,1 vjet. Indeksi sintetik i fekonditetit vazhdon të jetë nën nivelin e zëvendësimit (2,1 fëmijë për grua). Në vitin 2017 numri mesatar i fëmijëve për grua është 1,48, duke shënuar një rënie krahasuar me vitin 2016, ku ky indeks ishte 1,54 fëmijë për grua.

Në vitin 2017, mosha mesatare në martesë si për meshkujt dhe për femrat ka pësuar rritje. Një burrë martohet në moshën 31,5 vjeç dhe një grua në moshën 26,5 vjeç.

Vdekshmëria foshjore në 2017 është rreth 8 vdekje për mijë lindje të gjalla, duke pësuar rënie krahasuar me 2016.

A e dini se?

Dhëndri më i ri i martuar në 2017 është 18 vjeç, ndërsa nusja më e re është 15 vjeç.

POPULLSIA E SHQIPËRISË

	Njësia	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018
Popullsia në 1 Janar	**Milion**	**2,91**	**2,90**	**2,90**	**2,89**	**2,89**	**2,88**	**2,88**	**2,87**
0-14	në përqindje	21,6	20,7	20,1	19,6	19,0	18,5	18,2	17,7
15-59	%	63,0	63,4	63,6	63,5	63,4	63,3	63,0	62,7
60-79	-	13,5	13,9	14,3	14,8	15,4	15,9	16,5	17,1
80 +	-	2,0	2,0	2,0	2,1	2,2	2,3	2,4	2,5
Popullsia sipas qarqeve									
Berat	%	5,1	5,1	5,0	4,9	4,8	4,7	4,6	4,4
Dibër	-	5,0	4,9	4,8	4,6	4,5	4,5	4,4	4,2
Durrës	-	9,3	9,4	9,5	9,5	9,6	9,7	9,9	10,1
Elbasan	-	10,6	10,4	10,3	10,2	10,1	10,0	9,9	9,7
Fier	-	11,2	11,1	10,9	10,8	10,7	10,6	10,5	10,4
Gjirokastër	-	2,7	2,6	2,5	2,5	2,4	2,4	2,3	2,2
Korçë	-	7,9	7,9	7,8	7,7	7,6	7,6	7,5	7,3
Kukës	-	3,1	3,0	3,0	2,9	2,9	2,8	2,8	2,7
Lezhë	-	4,8	4,7	4,7	4,6	4,6	4,5	4,5	4,4
Shkodër	-	7,8	7,7	7,6	7,5	7,4	7,3	7,2	7,1
Tiranë	-	26,3	26,9	27,5	28,2	28,9	29,3	30,0	30,8
Vlorë	-	6,4	6,4	6,5	6,5	6,5	6,5	6,6	6,6

TREGUES KRYESOR DEMOGRAFIK TË SHQIPËRISË

	Njësia	2013	2014	2015	2016	2017
Jetëgjatësia	vite					
Meshkuj	-	75,9	76,4	76,3	77,0	77,1
Femra	-	80,1	80,1	79,7	80,1	80,0
Indeksi sintetik i fekonditetit	për grua	1,76	1,73	1,60	1,54	1,48
Mosha mesatare në martesë	vite					
Meshkuj	-	29,3	29,5	29,6	30,4	31,5
Femra	-	23,7	24,0	24,1	25,1	26,5
Martesat	për 1000 banorë	8,2	8,2	8,7	7,8	7,9
Lindjet	-	12,3	12,4	11,4	11,0	10,7
Vdekjet	-	7,1	7,1	7,8	7,4	7,7
Vdekshmëria foshnjore	për 1000 lindje	7,6	7,9	7,1	8,7	8,0
Vdekshmeria nën 5 - vjeç	-	9,8	9,2	9,0	10,2	9,2

STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË GRUPEVE KRYESORE TË KONSUMIT



- Ushqim, pije alkolike dhe duhan
- Shpenzime për banesën, ujë, energji elektrike, qira të paguar dhe mobilim
- Shëndet
- Arsim
- Restorante dhe hotele
- Të tjera mallra dhe shërbime

STATISTIKAT E KONSUMIT TË NjEF

Anketa e Buxhetit të Familjes është një vrojtim statistikor që kryhet pranë njësive ekonomike familjare (NjEF) dhe jep një panoramë të situatës socio-ekonomike të NjEF në Shqipëri. Sipas Anketës së Buxhetit të Familjes 2016, struktura e shpenzimeve mesatare mujore për konsum të NjEF sipas 12 grupeve kryesore të konsumit tregon se grupet "Ushqime, pije alkoolike dhe duhan" zënë peshën kryesore në buxhetin familjar me 48,7 %. Këto grupe shënojnë uljen më të madhe të shpenzimeve mesatare për konsum mujor në vitin 2016, 3,6 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2015. Ndërsa rritja më e madhe është regjistruar në grupin "Arsim" me 2,3 pikë përqindje. Grupet e shpenzimeve për banesën (energji elektrike, ujë, lëndë djegëse, qira e paguar) dhe mobilim zënë 15,2 % të totalit të buxhetit familjar duke shënuar ulje prej 0,1 pikë përqindje krahasuar me vitin e mëparshëm. Përqindja e buxheti të NjEF për grupin "Shëndet", zë një peshë prej 3,4 % duke shënuar ulje prej 0,2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015.

A e dini se?

Shpenzimet për restorante zënë 88,5 % të grupit kryesor restorante dhe hotele, ndërsa shpenzimet për hotele vetëm 11,5 %.

BUXHETI I FAMILJEVE

STATISTIKAT E KUSHTEVE TË BANIMIT TË NjEF

Sipas Anketës së Buxhetit të Familjes 2016, 70,9 % e Njësive Ekonomike Familjare (NjEF) jetojnë në shtëpi private. NjEF të cilat jetojnë në banesa që janë pjesë të ndërtesave me 15 apartamente zënë 16,0 %, përqindje e cila regjistron rritje prej 2,4 pikë përqindje krahasuar me vitin 2015. Ndërsa banesa që janë pjesë të ndërtesave me 15 apo më shumë apartamente zënë 12,4 % të NjEF në Shqipëri (Tabela 1).

Banesat me sipërfaqe deri në 90 metra katrorë zënë peshën më të madhe të të gjithë banesave, 52,9 % në vitin 2016. Banesat me sipërfaqe 91-130 metra katrorë renditen në vendin e dytë përsa i përket shpërndarjes, me 33,8 %, të cilat shënojnë një rritje prej 2,5 pikë përqindje krahasuar me vitin e kaluar.

Pjesa më e madhe e banesave janë në pronësi të familjeve, 91,8 %. Kategoritë e tjera, banesa të marra me qira ose falas, zënë një përqindje shumë të vogël të banesave ku NjEF jetojnë, përkatësisht 6,3 % dhe 1,9 %.

TABELA 1

NjEF SIPAS LLOJIT TË BANESËS — NjEF në %

Lloji i banesës	2014	2015	2016
Shtëpi për një familje	78,3	75,4	70,9
Banesë në një ndërtesë me deri 15 apartamente	10,8	13,6	16,0
Banesë në një ndërtesë me më shumë se 15 apartamente	10,1	10,7	12,4
Tjetër	0,8	0,3	0,7

TABELA 2

NjEF SIPAS SIPËRFAQES SË PËRDORUR TË BANESËS — NjEF në %

Sipërfaqja e banesës	2014	2015	2016
Më pak se 50 m^2	7,8	7,8	7,1
51-90 m^2	49,8	53,7	52,9
91-130 m^2	33,3	31,3	33,8
Më shumë se 130 m^2	9,1	7,1	6,2

TABELA 3

NjEF SIPAS STATUSIT TË PRONËSISË SË BANESËS — NjEF në %

Statusi i pronësisë	2014	2015	2016
Pronar ose duke u berë pronar (ka marrë hua, kredi ose në pritje të legalizimit)	94,0	93,0	91,8
Me qira (nga një person privat ose nga shteti)	4,1	5,5	6,3
Jeton falas /e ka në përdorim /tjetër	1,9	1,5	1,9

A e dini se?

Në familjet që banojnë në banesa për qëllime banimi, 6,3 % e tyre jetojnë në kushte mbipopullimi të cilat kanë një sipërfaqe mesatare rreth 13 metra katrorë për person.

SHPENZIMET PUBLIKE NË SHËNDETËSI



* Të dhënat janë paraprake
Burimi i informacionit: Ministria e Financave

Shpenzimet publike në sektorin e shëndetësisë për vitin 2017 kanë qenë 45,532 miliardë lekë. Këto shpenzime përbëjnë 9,83 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2017 dhe zënë një peshë prej 2,92 % në PBB-në gjithsej. Shpenzimet publike në shëndetësi, shprehur si përqindje ndaj PBB dhe ndaj shpenzimeve publike gjithsej, kanë shënuar rritje krahasur me vitin 2016.

Numri i vdekjeve në vitin 2017, vjen për 90 përqind nga shkaqe natyrale, ndërsa aksidentet janë shkaku i dytë kryesor i tyre me një nivel thuajse të pandryshuar në vitet e fundit, prej 2,1 %.

SHKAQET E VDEKJEVE

Shkaqet e vdekjeve	2015	2016	2017
Natyrale	86,8	87,4	90,1
Aksident	2,2	2,1	2,1
Vetëvrasje	1,0	1,1	0,9
Vrasje	0,4	0,4	0,3
Aksident në punë	0,3	0,2	0,3
E panjohur	9,3	8,8	6,3

Burimi i informacionit: Drejtoria e Gjendjes Civile

A e dini se?

Në vitin 2017, janë gjithsej 1.568 mjek specialist në spitalet publike.

SHËNDETËSIA

Sipas grup-sëmundjeve, shkaku kryesor i vdekjeve janë "Sëmundjet e aparatit të qarkullimit të gjakut", 53,6 % ndjekur nga grupi "Tumore" me 16,4 % dhe "Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë", 16,0 %.

Në vitin 2017, treguesit e mbulesës vaksinale vazhdojnë të jenë të lartë për të gjitha llojet e vaksinave në moshat respektive.

Shtrirja në të gjithë vendin e ketij shërbimi dhe në kohën e duhur në vitin 2017 ka dhënë efektet kryesisht në parandalimin e sëmundjes së fruthit.

GRUP-SËMUNDJET

Kodi ICD-9	Grup-sëmundjet	Vitet 2015	2016	2017
001-139	Sëmundje infektive e parazitare	0,2	0,1	0,2
140-239	Tumore	16,4	16,7	16,4
240-279	Sëmundje endokrine të të ushqyerit	1,4	1,4	1,4
280-289	Sëmundje të gjakut dhe të organeve formuese të gjakut	0,1	0,2	0,2
290-319	Sëmundje mendore	0,6	0,5	0,4
320-389	Sëmundje të sistemit nervor qendror dhe të organeve të shqisave	1,7	1,4	1,6
390-459	Sëmundje të aparatit të qarkullimit të gjakut	54,7	54,4	53,6
460-519	Sëmundje të aparatit të frymëmarrjes	2,9	2,6	3,0
520-579	Sëmundje të aparatit të tretjes	1,2	1,4	1,4
580-629	Sëmundje të organeve urogenitale	1,4	1,2	1,1
630-639	Ndërlikime në barrë, të lindjes dhe të periudhës së paslindjes	0,4	0,4	0,3
680-709	Sëmundje të lëkurës dhe të indit qelizor në lëkurë	0,0	0,0	0,0
710-739	Sëmundje të sistemit të kockave dhe të kyçeve	0,1	0,1	0,2
740-759	Anomali të bashkëlindura	0,2	0,2	0,1
760-779	Sëmundje që shfaqen në periudhën rreth lindjes	0,3	0,4	0,4
780-799	Simptoma, shenja dhe sëmundje të papërcaktuara mirë	14,1	15,0	16,0
800-999	Dëmtime traumatike dhe helmime	4,3	4,2	3,7

SHËRBIMI PARËSOR

Emërtimet	Vitet 2015	2016	2017
Fëmijë vaksinuar për:			
– tuberkulozin	99,7	99,2	99,0
– difterinë	98,8	98,7	99,0
– tetanozin	98,8	98,7	99,0
– pertusin	98,8	98,7	99,0
– fruthin-rubeole-parotit	97,8	96,3	95.7
– poliomilitin	98,8	98,3	98.9

NUMRI I VIZITAVE SHËNDETËSORE

	Vitet		
	2015	2016	2017
Vizita gjithsej	**7.746.290**	**8.120.123**	**7.942.742**
Qëndrat shëndetësore	**408**	**414**	**415**
Numri vizitave në Qendra shëndetësore	3.239.783	3.141.755	3.219.003
Vizita në moshat deri 14 vjeç	620	598	622.065
nga këto: nën 1 vjeç	17	168	164.598
Vizita në moshat mbi 14 vjeç	2.551.426	2.477.518	2.540.230
nga këto: mbi 60 vjeç	1.327.090	1.299.973	1.307.037
Vizita në banesë	68.286	66.493	56.708
Ambulanca	**2.133**	**2.062**	**2.022**
Numri vizitave në ambulanca	1.330.670	1.627.521	1.545.416
Vizita në moshat deri 14 vjeç	322.393	354.070	345.029
nga këto: nën 1 vjeç	89.422	93.487	93.894
Vizita në moshat mbi 14 vjeç	928.092	1.107.761	1.100.013
nga këto: mbi 60 vjeç	582.070	616.024	741.503
Vizita në banesë	80.185	165.690	100.374
Poliklinika	**46**	**46**	**46**
Numri vizitave në poliklinika	3.175.837	3.350.847	3.178.323
Vizita në moshat deri 14 vjeç	468912	469215	451000
Vizita në moshat mbi 14 vjeç	2706925	2881632	2727323

Burimi i informacionit: Ministria e Shëndetësisë dhe Shërbimit Social

Një rëndësi të veçantë në shërbimin shëndetësor në vend ka shërbimi parësor, ky shërbim ofrohet nëpërmjet qendrave shëndetësore, ambulancave dhe poliklinikave.

A e dini se?

Në vitin 2017, grupmosha 50-59 zë peshën më të lartë, 34 % në kontrollet bazë gjithsej.

STATISTIKAT E KRIMEVE

Në vitin 2017 janë evidentuar gjithsej 34.317 vepra penale, rreth 1,5 % më shumë vepra krahasuar me vitin 2016. Ndërkohë numërohen 36.051 autorë të dyshuar, rreth 4,0 % më shumë krahasuar me vitin e kaluar. Numri i autorëve të veprave penale ndryshon nga një qark në tjetrin. Në vitin 2017, qarqet me numrin absolut më të madh të autorëve të veprave penale janë Tirana, Durrësi dhe Vlora. Nëse do shpreheshim në raport me popullsinë, qarqet me normën më të lartë janë Lezha, Gjirokastra dhe Tirana, përkatësisht 167, 163 dhe 154 autorë të dyshuar për 10 mijë banorë. Ndërkohë qarqet me normën më të ulët janë Dibra dhe Elbasani, 79 dhe 87 autorë të dyshuar për 10 mijë banorë.

AUTORE TË VEPRAVE PENALE SHPREHUR PËR 10.000 BANORË



> 160.0
120.1 - 160.0
90.0 - 120.0
< 90.0

Persona të dyshuar në kryerjen e veprave penale për 10.000 banorë.

Vlera më e lartë: 167,1 (Lezhë)
Vlera më e ulët: 79,3 (Dibër)

Burimi:
Drejtoria e Policisë së Shtetit
INSTAT

Shënim : Kufijtë administrativë janë krijuar për qëllime statistikore dhe mund të mos përputhen plotësisht me territorin e njësive lokale.

A e dini se?

Qarqet me numrin absolut më të madh të autorëve të veprave penale janë Tirana, Durrësi dhe Vlora.

TABELA 1

Vepra penale kundër personit	Vepra penale	Autorë
Krime kundër jetës	**1.413**	**1.566**
Vrasje	50	48
Vrasje mbetur tentativë	60	76
Kanosje	1.293	1.431
Të tjera	10	11
Krime kundër shëndetit	**2.668**	**3.505**
Plagosje e rëndë me dashje	117	134
Plagosje e lehtë me dashje	1.165	1.576
Dëmtime tjera me dashje	1.366	1.776
Të tjera	20	19
Krime seksuale	**113**	**111**
Vepra penale kundër lirisë së personit	**201**	**243**
Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë	26	42
Heqja e paligjshme e lirisë	32	44
Dhunim banese	77	80
Të tjera	66	77
Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit	**486**	**604**
Prostitucioni	35	96
Shfrytezim prostitucioni	93	124
Mbajtja e lokaleve për prostitucion	24	39
Fyerja	124	148
Të tjera	210	197
Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes	**1.657**	**1.782**
Braktisja fëmijës së mitur	101	105
Trafikimi i të miturit	22	25
Dhuna në familje (130/a)	1.412	1.507
Të tjera	122	145
Të tjera kundër personit	**94**	**103**
Gjithsej	**6.632**	**7.914**

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Shënim: Autorë janë persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale

Në vitin 2017 janë evidentuar 6.632 vepra penale kundër personit, 2 më pak krahasuar me vitin 2016. Veprat penale kundër personit të evidentuara përbëjnë rreth 19,3 % të totalit të gjithë veprave penale për vitin 2017.

Për veprat penale kundër personit numërohen 7.914 autorë të dyshuar në kryerjen e këtyre veprave penale. Krahasuar me vitin 2016 janë rreth 2,3 % më shumë autorë të dyshuar.

Numrin më të madh të veprave penale të evidentuara kundër personit e zënë krimet kundër shëndetit, rreth 40,2 % të totalit të veprave kundër personit. Veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes përbëjnë grupveprën e dytë me numrin më të madh të krimeve të evidentuara, rreth 25,0 % të totalit të veprave kundër personit.

A e dini se?

Gjatë vitit 2017, u raportuan mesatarisht rreth 3 vjedhje banese në ditë.

ARSIMI DHE NJOHURITË

Shpenzimet publike në arsim për vitin 2017 kanë qenë 47,9 miliardë lekë. Këto shpenzime përbëjnë 10,4 % të shpenzimeve publike gjithsej për vitin 2017 dhe zënë një peshë prej 3,1 % në PBB-në gjithsej.

Në vitin 2017, u regjistruan në të gjithë nivelet e arsimit zyrtar, 649.938 nxënës dhe studentë, me një ulje prej 4,1 %, krahasuar me të regjistruarit e vitit 2016.

Në fillim të vitit shkollor 2017-2018, pjesëmarrja në të gjithë nivelet e arsimit në krahasim me popullsinë e moshës shkollore, ose GER, ishte 82,8 %. Megjithatë raporti është i ndryshëm në nivele të ndryshme arsimore. Për vitin shkollor 2017-2018, GER në arsimin 9 vjeçar ishte 100,7 % me një rritje të lehtë nga viti paraardhës. Ky raport tregon për pjesëmarrje të lartë të popullsisë në këtë nivel arsimor, që ka të bëjë edhe me faktin se arsimi 9 vjeçar është i detyruar. GER në arsimin e lartë është 53,9 %.

NER llogaritet vetëm për arsimin parauniversitar. Në vitin 2017 morën pjesë në arsimin 9 vjeçar 96,5 % nxënës të grupmoshës 6-14 vjeç në krahasim popullsinë përkatëse, përkundrejt 92,3 % të tyre në vitin 2016. NER në arsimin e e mesëm ishte 76,7 % përkundrejt 77,1 % që ishte në vitin 2016.

A e dini se?

Në vitin shkollor 2017-2018, pjesëmarrja e popullsisë së moshës shkollore në të gjithë nivelet e arsimit GER, ishte 82,8 %.

SHPENZIMET PUBLIKE NË ARSIM



* Të dhënat janë paraprake
Burimi i informacionit: Ministria e Financave

NXËNËS DHE STUDENTË TË REGJISTRUAR GJITHSEJ NË ARSIM

Niveli ISCED	Viti shkollor / akademik	2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18
	Të regjistruar gjithsej në arsim akademik	**786.230**	**748.488**	**704.779**	**677.818**	**649.938**
0	Në kopshte	81.448	82.494	82.623	81.194	81.026
1+2	Në arsimin 9 vjeçar:	377.074	363.408	343.499	328.100	319.671
1	*Fillore*	195.720	188.371	179.564	174.836	170.861
2	*Cikli i lartë i arsimit 9 vjeçar*	181.354	175.037	163.935	153.264	148.810
3	Në arsimin e mesëm:	151.937	140.042	130.380	127.114	120.062
34	*Gjimnaz*	124.619	112.775	104.952	101.995	95.306
35	*Profesional*	27.318	27.267	25.428	25.119	24.756
4	Në arsimin pas të mesëm jo i lartë	1.952	2.017	1.521	1.803	2.439
6+7+8	Në arsimin e lartë	173.819	160.527	146.756	139.607	129.179

Burimi i informacionit: Të dhënat administrative nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë

RAPORTI NXËNËS PËR MËSUES, PTR

Niveli ISCED	Viti shkollor	2013-14	2014-15	2015-16	2016-17	2017-18
		786.230	**748.488**	**704.779**	**677.818**	**649.938**
	Në arsimin publik					
1	*Fillore*	19,1	18,9	18,3	18,2	17,8
	Qytet	25,4	25,0	24,0	23,8	23,2
	Fshat	15,2	14,9	14,8	14,6	14,2
2	*Cikli i lartë i arsimit 9 vjeçar*	12,6	12,2	11,1	10,4	10,1
	Qytet	15,2	14,9	13,4	12,8	12,3
	Fshat	10,7	10,3	9,4	8,7	8,5
3	*Arsimi i mesëm*	17,0	16,2	15,0	14,4	13,8
	Qytet	17,2	16,9	15,6	15,0	14,6
	Fshat	16,4	14,5	13,8	13,0	11,9
	Në arsimin privat					
1	Në fillore	16,0	15,3	16,4	15,1	15,0
	Qytet	15,9	15,1	16,3	15,0	15,0
	Fshat	17,9	18,1	17,4	16,6	15,8
2	*Në ciklin e lartë të 9 vjeçares*	8,8	8,3	7,8	7,6	7,7
	Qytet	8,8	8,2	7,8	7,2	7,3
	Fshat	8,1	9,6	8,1	n,a	n,a
3	*Në arsimin e mesëm*	9,7	9,1	8,2	9,0	8,7
	Qytet	9,3	9,9	8,4	9,0	8,8
	Fshat	n,a	3,4	6,5	8,0	7,7

Në vitin shkollor 2017-2018, marrin pjesë në arsimin publik 92,8 % e nxënësve të arsimit 9 vjeçar dhe 88,4 % e nxënësve të arsimit të mesëm. Pjesëmarrja në arsimin e mesëm profesional paraqitet me rritje në vitet e fundit. Në vitin shkollor 2017-2018 marrin pjesë në arsimin profesional 20,6 % e nxënësve të arsimit të mesëm gjithsej, ndërsa vetëm në arsimin publik kjo përqindje është 27,8 % .

Në vitin 2017 përfunduan studimet në arsimin 9 vjeçar dhe u diplomuan 36.546 nxënës. Këtë vit përfunduan studimet në arsimin e mesëm dhe u diplomuan 36.436 nxënës, me një raport bruto të diplomimit GGR prej 80,1 %. Ky raport ka pësuar një ulje prej 4,1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2016.

PJESËMARRJA NË ARSIM SIPAS RAPORTEVE GER DHE NER (%)



ARSIMI DHE NJOHURITË

Të diplomuarit e arsimit profesional përbëjnë 14,3 % të të diplomuarve të arsimit të mesëm me një rritje prej 2,3 pikë përqindje krahasuar me vitin 2016.
Në vitin 2017, janë diplomuar në arsimin e lartë 35.173 studentë ose 11,0 % më shumë se në vitin 2016. Ndër të diplomuarit e këtij viti në të gjithë programet, femrat përbëjnë 64,1 %. Të diplomuarit në programet Bachelor përbëjnë 58,1 % të studentëve të diplomuar gjithsej.

Fusha e studimit që zë peshën më të lartë ndër 10 fusha të gjera të studimit është "Biznesit, administrimit dhe ligjit" në të cilën janë diplomuar 29,6 % e studentëve gjithsej. Pikërisht kjo fushë studimi ka qenë më e preferuar si nga meshkujt ashtu edhe nga femrat.

Fusha e dytë më e preferuar për femrat është "Shëndetit dhe mirëqenies", ndërsa për meshkujt "Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim", njëlloj si viti paraardhës.

SHKALLA E DIPLOMIMIT NË ARSIMIN E MESËM, GGR (%)



TË DIPLOMUAR NË ARSIMIN E LARTË SIPAS FUSHAVE TË STUDIMIT, 2017



Sipas Manualit të Fushave të studimit ISCED- F2013

A e dini se?

Në vitin 2017, të diplomuarit në arsimin e lartë janë 11,0 % më shumë se në vitin 2016.

NUMRI GJITHSEJ I SHFAQJEVE / EKSPOZITAVE DHE SPEKTATORËVE/VIZITORËVE NË INSTITUCIONET KULTURORE

Institucionet e Kulturës dhe Artit	Numri i shfaqjeve/ekspozitave		Numri i spektatorëve / vizitorëve/audienca	
	2016	2017	2016	2017
Teatri Kombëtar Popullor	118	143	25.761	36.092
Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor	131	99	17.773	49.284
Teatri Kombëtar Eksperimental	338	320	27.060	29.936
Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit	152	65	6.133	2.530
Galeria Kombëtare e Arteve	20	17	16.178	37.598
Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë	202	187	20.818	18.514
Numri gjithsej	**961**	**831**	**113.723**	**173.954**

VIZITORË NË MUZE, PARQE ARKEOLOGJIKE DHE KALA



Gjatë vitit 2017, numri i shfaqjeve në institucionet qëndrore të artit ka pësuar rënie krahasuar me një vit më parë, ndërsa numri i spektatorëve është rritur me rreth 53,0 %. Në institucionet kombëtare të artit, gjatë vitit 2017 janë organizuar 831 shfaqje dhe kanë marrë pjesë 173.954 spektatorë. Numri mesatar i spektatorëve është rritur nga rreth 118 spektatorë për shfaqje gjatë vitit 2016, në rreth 209 gjatë vitit 2017 që tregon se rritja e numrit të spektatorëve ka ardhur si rezultat i rritjes së pjesëmarrjes në aktivitete të tilla.

Gjatë vitit 2017, në teatrot kombëtare, TKP, TKOB dhe TKEKS, janë realizuar 562 shfaqje, duke pësuar një rënie me 4,3 % krahasuar me vitin 2016. Ndërsa, numri i spektatorëve në vitin 2017 ka shënuar një rritje me 63,3 % krahasuar me vitin e mëparshëm. Një situatë e ngjashme paraqitet edhe për Galerinë Kombëtare të Arteve e cila ka zhvilluar 3 ekspozita më pak se në 2016, ndërsa numri i vizitorëve është rritur nga 16,2 mijë në 37,6 mijë. Vetëm Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit dhe Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë kanë patur më pak shfaqje dhe spektatorë gjatë 2017 krahasuar me vitin 2016.

Numri i vizitorëve në muze në vitin 2017 është 206.838, duke shënuar rritje me 33,5 %, krahasuar me 2016. Në kala e monumente të tjera, numri i vizitorëve ka një rritje prej 22,3 %, në vitin 2017 në krahasim me vitin 2016. Në parqet arkeologjike, numri i vizitorëve është 261.074, me një rritje prej 13,4 %, krahasuar me vitin e mëparshëm.

A e dini se?

Teatri Kombëtar Eksperimental është institucioni që ka realizuar numrin më të lartë të shfaqjeve kulturore, për vitet 2016 dhe 2017.

TREGU I PUNËS

PAPUNËSIA

Tregu shqiptar i punës, gjatë vitit 2017, u karakterizua nga një rënie e shkallës së papunësisë, krahasuar me një vit më parë. Shkalla e papunësisë, në 2017, për popullsinë e grup moshës 15 vjeç e lart arriti në 13,7 %, duke shënuar një ulje me 1,5 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë.

Ndikimin më të madh në këtë ulje vazhdojnë ta kenë femrat, për të cilat niveli i papunësisë arrin në 12,6 %, nga 14,4 % që ishte në vitin 2016.

Gjatë vitit 2017, popullsia e grup moshës 15-29 vjeç pati ndikimin më të madh në nivelin e papunësisë. Shkalla e papunësisë për këtë grupmoshë në vitin 2017 u ul në 25,9 %, nga 28,9 % që ishte në vitin 2016. Ndikimin më të madh në uljen e këtij treguesi e dhanë femrat, për të cilat ulja ishte 3,8 pikë përqindje.

Për popullsinë e grupmoshës 30-64 vjeç, niveli i papunësisë në vitin 2017 u ul në 10,8 %, nga 11,8 % që ishte në vitin 2016.

Të rinjtë e grupmoshës 15-29 vjeç të cilët nuk janë as në punësim e as duke vazhduar shkollën apo ndonjë trajnim përbëjnë 29,7 % të të rinjve gjithsej për vitin 2017.

A e dini se?

Shkalla e papunësisë së të rinjve pësoi një rënie prej 3 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë.

TË RINJ TË MOSHËS 15-24 JO NË PUNËSIM DHE AS NË ARSIMIM APO TRAINIM (NEET), (NË DISA VENDE TË RAJONIT) %



PAPUNËSIA

	Njësia	2015	2016	2017
Të papunë	1 000	**224**	**208**	**190**
Meshkuj	-	128	123	116
Femra	-	96	85	74
Shkalla e papunësisë	%	**17,1**	**15,2**	**13,7**
Meshkuj	-	17,1	15,9	14,6
Femra	-	17,1	14,4	12,6

Burimi: Anketa e Forcave të Punës 2015-2017

SHKALLA E PAPUNËSISË
Të papunët si përqindje ndaj totalit të forcave të punës.
PAPUNËSIA
Personat 15-74 vjeç të cilët në një periudhë të caktuar reference plotësojnë njëkohësisht këto tre kritere: nuk kishin një punë, ishin duke kërkuar punë aktivisht dhe janë të gatshëm që të fillojnë punë nëse do t'u ofrohej një e tillë (në përputhje me definicionin e ILO-s).

SHKALLA E PUNËSIMIT, GRUPMOSHA 20-64 VJEÇ; 2017



Në vitin 2017, shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 57,4 %. Në Shqipëri meshkujt janë më aktivë në tregun e punës. Shkalla e punësimit për meshkujt 15-64 vjeç në vitin 2017 ishte 64,3 %, ndërsa për femrat 50,3 %, duke patur pra një hendek gjinor në punësim prej 14,0 pikë përqindje.

Në nivel vendi, sektori bujqësor dhe sektori i shërbimeve kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 38,2 % dhe 42,4 %, ndërsa punësimi në industri përbën 19,4 % të të punësuarve gjithsej në vitin 2017.

A e dini se?

Në vitin 2017, shkalla e inaktivitet-it në tregun e punës ka pësuar rënie krahasimisht me vitin paraardhës, nga 42,5 % në 41,7 %.

TREGU I PUNËS

PUNËSIMI

Një pjesë e konsiderueshme e femrave në moshë pune punojnë si punëtore pa pagesë në biznesin e familjes, kryesisht në fermat bujqësore. Në vitin 2017, femrat kanë 1,8 herë më shumë gjasa sesa meshkujt për të qenë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes; 26,8 % e femrave të punësuara janë punëtore pa pagesë në biznesin familjar kundrejt 15,1 % të meshkujve të punësuar.

Në vitin 2017 përqindja e punësimit informal në sektorin jo-bujqësor është 30,3 %, duke pësuar një rënie me 1,6 pikë përqindje krahasuar me vitin 2016.

STATUSI NË LIDHJE ME PUNËSIMIN I POPULLSISË

	Njësia	2015	2016	2017
Popullsia gjithsej	**1 000**	**2.886**	**2.876**	**2.877**
Forcat e punës gjithsej	**-**	**1.310**	**1.365**	**1.385**
Meshkuj	-	748	773	795
Femra	-	562	592	590
Të punësuar gjithsej	**-**	**1.087**	**1.157**	**1.195**
Meshkuj	-	621	650	679
Femra	-	466	507	516
Shkalla e punësimit*	**përqindje**	**52,9**	**55,9**	**57,4**
Meshkuj	-	60,5	61,9	64,3
Femra	-	45,5	49,7	50,3

Burimi: Anketa e Forcave të Punës, 2015-2017
*) llogaritur mbi popullsinë 15-64 vjeç

FORCAT E PUNËS
Shuma e personave të punësuar dhe të papunë në moshë 15 vjeç e lart.

IÇK SIPAS GRUPEVE KRYESORE

COICOP		Njësia	2015	2016	2017
000000	**Gjithsej**	Ndryshimi	1,9	1,3	2,0
01.	Ushqime dhe pije joalkoolike	mesatar	4,3	3,3	3,9
02.	Pije alkoolike dhe duhan	vjetor	5,8	1,8	0,7
03.	Veshje dhe këpucë	në %	-1,7	-1,1	-1,1
04.	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji		-0,5	0,1	1,0
05.	Mobilim, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë		-0,1	0,7	-0,4
06.	Shëndeti		-1,9	-0,9	0,0
07.	Transporti		-2,0	-2,9	1,9
08.	Komunikimi		1,5	-0,4	0,3
09.	Argëtim dhe kulturë		0,6	1,4	1,5
10.	Shërbimi arsimor		8,8	3,6	0,7
11.	Hotele, kafene dhe restorante		0,8	0,7	0,1
12.	Mallra dhe shërbime të ndryshme		-0,5	1,0	2,2

INDEKSI I ÇMIMEVE TË KONSUMIT

Ndryshimi mesatar vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit në vitin 2017 është 2,0 %, nga 1,3 % që ishte në vitin 2016. Rritja më e madhe e çmimeve prej 3,9 % vërehet në grupin "Ushqime dhe pije alkoolike" duke kontribuar me +1,52 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor. Indeksi i grupi "Mallra dhe shërbime të tjera" ka shënuar një rritje prej 2,2 % duke ndikuar me +0,11 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor. Indeksi i grupit "Transport" ka shënuar një rritje prej 1,9 % me një ndikim prej +0,12 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor. Indeksi i grupit "Transporti" është ndikuar nga rritja prej 3,8 % që ka pësuar indeksi i çmimeve të nëngrupit "shërbime ndaj mjeteve personale të transportit", nëngrup ku peshën më të madhe e zënë karburantet. Muaji Prill i vitit 2017, ka rezultuar muaji me rritjen më të lartë të ndryshimit vjetor të indeksit për nëngrupin "shërbime ndaj mjeteve personale të transportit", përkatësisht me 7,4 % krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë.
Ulja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin "Veshje dhe këpucë" me 1,1 % duke kontribuar me -0,04 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor. Indeksi i grupit "Mobilim, paisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë" shënoi një ulje prej 0,4 % me një ndikim prej -0,03 pikë përqindje në ndryshimin mesatar vjetor.

A e dini se?

Në vitin 2017 indeksi i çmimeve të nëngrupit "Qumësht, djathë dhe vezë" ka shënuar një rritje prej 3,3 % krahasuar me nje vit më parë

LLOGARITË KOMBËTARE

Gjatë vitit 2016 ekonomia shqiptare shënoi një rritje reale prej 3,35 % krahasuar me vitin 2015, bazuar kjo mbi vlerësimet gjysëm finale. Konsumi final përbën peshën kryesore të shpenzimeve në ekonomi, me 92,54 % dhe u rrit me 2,94 % në terma reale.

Formimi bruto i kapitalit fiks u rrit me 3,34 % në terma reale krahasuar me vitin 2015. Eksporti i mallrave dhe shërbimeve është rritur në terma reale me 11,34 %, dhe importi i mallrave dhe shërbimeve u rrit me 6,95 % krahasuar me vitin 2015. PBB për frymë në vitin 2016 arriti në 513 mijë lekë.

PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO
PBB përfaqëson vlerën totale në para të të gjithë të mirave dhe shërbimeve të prodhuara gjatë një periudhe specifike nga njësitë prodhuese rezidente brenda territorit ekonomik të një vendi. Metodat e përdorura në Shqipëri për llogaritjen e PBB-së janë metoda e prodhimit dhe e shpenzimeve.

IÇK SIPAS GRUPEVE KRYESORE

	Njësia	2014	2015	2016	Struktura e PBB (%) 2014	2015	2016
PBB (me çmime korrente)	Mln Lekë	**1,395,305**	**1,434,307**	**1,475,251**			
Burimet (me çmime korrente)	Mln Lekë						
PBB	-	1.374.009	1.426.263	1.482.387	100,0	100,0	100,0
Importet e mallrave e shërbimev e (fob)	-	658.512	638.749	674.866	47,9	44,8	45,5
Përdorimet (me çmime korrente)	-						
Eksportet e mallrave e shërbimev e (fob)	-	393.657	391.098	426.693	28,7	27,4	28,8
Konsumi Final i Popullatës	-	1.119.647	1.146.558	1.186.805	81,5	80,4	80,1
Konsumi Final i Administratës Publike dhe i Institucionev e Jo- timprurëse	-	167.371	170.213	178.465	12,2	11,9	12,0
Formimi Bruto i Kapitalit Fiks	-	337.087	350.164	361.989	24,5	24,6	24,4
Ndryshimet e gjendjeve dhe mospërputhje statistikore	-	36.054	15.022	(3.835)	2,6	1,1	-0,3
Rritja real vjetore e PPB	%	**1,77**	**2,22**	**3,35**			
Produkti i Brendshëm Bruto për frymë	1.000 lekë	483	498	513			
	Euro	3.450	3.563	3.734			
	USD	4.579	3.953	4.132			

2015* Të dhëna finale
2016** Të dhëna gjysëm finale

PRODUKTI I BRENDSHEM BRUTO



A e dini se?

Sipas PBB-së me metodën e prodhimit, kontributin kryesor në rritjen ekonomike e kanë dhënë degët e ekonomisë si "Tregtia, Transporti, akomodimi dhe shërbimi ushqimor" me 0.62 pikë përqindje.

LLOGARITË KOMBËTARE

LLOGARITË KOMBËTARE

	Njësia	2014	2015	2016	Struktura e PBB (%) 2014	2015	2016
PBB (me çmime korrente)	**Min lekë**	**1.395.305**	**1.434.307**	**1.475.251**	100,0	100,0	100,0
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi (Nace Rev.2, A)	-	278.924	283.709	293.674	20,0	19,8	19,9
Industria nxjerrëse; përpunuese; energjia elektrike & gazi (Nace Rev.2, B-E)	-	179.946	184.396	179.869	12,9	12,9	12,2
Ndërtimi (Nace Rev.2, F)	-	120.168	127.762	131.863	8,6	8,9	8,9
Shërbimet (Nace Rev.2, G-U)	-	638.806	663.859	688.569	45,8	46,3	46,7

2015* Të dhëna finale
2016** Të dhëna gjysëm finale

Përsa i përket strukturës së PBB sipas aktiviteteve ekonomike, peshën më të madhe në ekonomi për vitin 2016 vazhdojnë ta zënë Shërbimet gjithsej me 46,7 % të PBB, të cilat u rritën me 4,43 % në terma realë. Industria dhe Ndërtimi përbëjnë 21,1 % të Produktit të Brendshëm Bruto të cilat u rritën në terma realë përkatësisht: Industria me 1,34 % dhe Ndërtimi me 3,1 %. Bujqësia, gjuetia, pyjet dhe peshkimi përbëjnë 19,9 % të PBB-së dhe janë rritur me 1,67 % në terma realë.

STRUKTURA E PBB SIPAS AKTIVITETE KRYESORE (%)



A e dini se?

PBB për frymë e Shqipërisë e shprehur në Standartin e Fuqisë Blerëse është pothuajse sa një e treta e mesatares së PBB për frymë të vendeve të BE (BE 28 = 100).

REGJISTRI I NDËRMARRJEVE

Regjistri statistikor i ndërmarrjeve në fund të vitit 2017 numëron 162.452 ndërmarrje aktive. Ndërmarrjet me aktivitet ekonomik "Tregti" përfaqësojnë 30,1% të ndërmarrjeve gjithsej, ndërsa aktiviteti ekonomik "Informacion dhe komunikacion" përfaqëson vetëm 1,8 %.

Ndërmarrjet me formë ligjore "Person fizik" mbizotërojnë në ekonominë shqiptare me 60,5 % , nga të cilat 41,5 % ushtrojnë aktivitetin ekonomik në fushën e tregtisë.

Gjatë vitit 2015 e në vazhdim pranë drejtorive rajonale tatimore po regjistrohen edhe fermerët, për arsye të përfshirjes në skemën e kompensimit të TVSH-së. Deri në fund të vitit 2017 numërohen 36.520 fermerë.

Regjistri statistikor i ndërmarrjeve përmban të gjitha njësitë ligjore që janë regjistruar pranë sporteleve të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) apo edhe pranë organeve tatimore. Këto njësi janë të pajisura me numër identifikimi NIPT dhe ushtrojnë aktivitet ekonomik brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Regjistri statistikor i ndërmarrjeve përditësohet me burime administrative dhe vrojtime statistikore.

A e dini se?

Në vitin 2017, ndërmarrjet me origjinë nga shtetet e Bashkimit Evropian zënë afërsisht 2,6 % të ndërrmarjeve aktive gjithsej në Shqipëri dhe 66,7 % të ndërmarrjeve të huaja dhe të përbashkëta.

NDËRMARRJET AKTIVE SIPAS FORMËS LIGJORE

Forma ligjore	2015	2016	2017
Gjithsej	**152.288**	**160.679**	**162.452**
Fermerë	19.543	31.372	36.520
Persona Fizikë	103.414	100.955	98.264
Persona Juridikë	29.331	28.352	27.668
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	23.643	22,424	22.208
Shoqëri Aksionare	911	821	801
Ndërmarrje Shtetërore	935	980	932
Administrata Publike	498	797	804
OJF, Org. ndërkombëtare	2.410	2.465	2.272
Shoqëri të tjera	934	865	651

NDËRMARRJET AKTIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK

Aktiviteti ekonomik	2015	2016	2017
Gjithsej	**152.288**	**160.679**	**162.452**
Bujqësia, pyjet, peshkimi	21.194	32.659	37.684
Industria	11.810	11.302	11.066
Ndërtimi	4.946	4,624	4.500
Tregtia	53.699	51.245	48.873
Transporti dhe magazinimi	7.008	6.548	5.928
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	23.186	22.785	21.909
Informacioni dhe komunikacioni	2.453	2.530	2.927
Shërbime të tjera	27.992	28.986	29.565

NDËRMARRJET AKTIVE SIPAS MADHËSISË, %



TREGTIA E JASHTME

TREGTIA E JASHTME DHE BILANCI TREGTAR I MALLRAVE



2016* Gjysëm-finale
^ Seria 1996-2007 nuk reflekton rishikimet e reja

TREGTIA E JASHTME E MALLRAVE

milion lekë	1997	2002	2007	2012	2017
Eksporte (FOB)	21.044	47.490	97.171	213.030	272.988
Importe (CIF)	95.022	210.368	376.194	528.490	626.179
Bilanci tregtar (Exports-Imports)	-73.977	-162.877	-279.023	-315.460	-353.191
Volumi tregtar (Exports+Imports)	116.066	257.858	473.365	741.520	899.167
Përqindja e mbulimit (%)	22,1	22,6	25,8	40,3	43,6

PESË PARTNERËT KRZESORË TREGTARË, 2017

Exporte			Importe		
	milion lekë	**% ndaj gjithsej**		**milion lekë**	**% ndaj gjithsej**
Itali	146.040	53,5	Itali	179.232	28,6
Kosovë	20.924	7,7	Kosovë	50.779	8,1
Spanjë	14.992	5,5	Spanjë	50.713	8,1
Greqi	11.602	4,3	Greqi	49.879	8,0
Gjermani	10.861	4,0	Gjermani	49.484	7,9

Në vitin 2017 volumi tregtar i mallrave është rritur me 9,3 % krahasuar me 2016, duke patur një rritje vjetore për eksportet rreth 12,1 % dhe 8,1 % për importet.

Grupet më të rëndësishme të mallrave që eksporton Shqipëria janë: "Tekstile dhe artikuj tekstile", "Veshjet e këmbëve" dhe "Produktet minerale". Në vitin 2017 këto grupe kanë zëne respektivisht 22,0 %, 21,0 % dhe 15,8 % të eksporteve gjithsej.

Grupet më të rëndësishme të mallrave që importon Shqipëria janë: "Makineri e pajisje mekanike dhe elektrike" dhe "Tekstile dhe artikuj tekstile". Në vitin 2017 këto grupe kanë zëne respektivisht 14,5 % dhe 11,2 % të importeve gjithsej.

Tre nga partnerët kryesorë si për eksportet, ashtu edhe për importet për vitin 2017, janë Italia, Greqia dhe Gjermania, duke zënë rreth 61,7 % të eksporteve shqiptare dhe 44,7 % të importeve shqiptare.

Materiali qe nuk ndryshon: Bilanci tregtar është diferenca ndërmjet vlerës së mallrave që një vend eksporton dhe vlerës së mallrave që një vend importon.

A e dini se?

Në vitin 2017 Gjermania është partneri i dytë kryesor përsa i përket volumit tregtar duke zënë rreth 6,8 % të gjithë tregtisë së mallrave

TEKNOLOGJIA E INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

Ndërmarrjet me 10 dhe më shumë të punësuar, që e kanë përdorur kompjuterin për qëllime pune gjatë vitit 2016, përfaqësojnë 95,6 % të ndërmarrjeve ekonomike, nga 95,0 % që ishte në vitin 2015. Punonjësit që kanë përdorur kompjuter për qëllime pune përbëjnë 28,0 % të të punësuarve gjithsej në këto ndërmarrje duke u rritur me 3,6 % krahasuar me vitin e kaluar.

Përqindja e ndërmarrjeve që kanë akses në internet është 96,8 % e totalit të ndërmarrjeve që përdorin kompjuter, duke u rritur me 0,6 %, krahasuar me vitin 2015. Në vitin 2016, ndërmarrjet që kanë pasur faqe interneti janë 51,6 % e totalit. Në 66,1 % të ndërmarrjeve, faqja e internetit është përdorur për të shfaqur kataloget e produkteve ose çmimet e tyre.

Në vitin 2016, media sociale (Facebook, Linkedln,Twiter, Youtube etj) është përdorur nga 38,9 % e ndërmarrjeve me 10 dhe më shumë të punësuarduke u rritur me 4 % krahasuar me vitin 2015.

Në vitin 2016, vetëm 7,1 % e ndërmarrjeve kanë shitur produkte/shërbime nëpërmjet faqes së internetit apo aplikacioneve të dedikuara. Peshën më të madhe të tregtisë elektronike e zënë ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet në fushën informacion dhe komunikacioni me 24,7 %.

A e dini se?

Në vitin 2016, përqindja e përdorimit të kompjuterit me akses në internet nga ndërmarrjet në Shqipëri është vetëm 0,2 % më e ulët krahasuar me mesataren e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian (97%).

NDËRMARRJE QË SHESIN PRODUKTE/SHËRBIME ONLINE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK,2016



PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË NDËRMARRJE, 2015-2016

	2015	2016
Ndërmarrje që përdorin kompjuter për qëllime pune	95,0	95,6
Punonjës që përdorin kompjuter në ndërmarrje për qëllime pune	24,4	28,0
Ndërmarrje që kanë akses në internet	96,2	96,8
Ndërmarrje që kanë faqe interneti	48,8	51,6
Ndërmarrje që përdorin media sociale për qëllime pune	37,4	38,9
Ndërmarrje që shesin produkte/shërbime online	8,8	7,1

PËRDORIMI I TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT NË NDËRMARRJE SIPAS MADHËSISË SË NDËRMARRJES, 2016

Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrje që përdorin kompjuter	Punonjës që përdorin kompjuter në ndërmarrje për qëllime pune	Ndërmarrje që kanë akses në internet	Ndërmarrje që shesin produkte/ shërbime online
10-49 të punësuar	95,0	31,0	96,1	6,7
50-249 të punësuar	98,7	22,2	100,0	6,4
250+ të punësuar	100,0	31,2	100,0	9,7

MBETJET URBANE DHE INERTE SIPAS QARQEVE, 2016.

Qarqet	Popullsia	Mbetje Urbane (ton)	Kilogram/banorë	Inerte (ton)
Gjithsej	**2.875.592**	**1.300.377**	**452**	**203.009**
Berat	135.441	64.500	476	5.763
Dibër	129.056	22.727	176	4.740
Durrës	280.205	156.218	558	7.594
Elbasan	287.606	99.617	346	6.217
Fier	305.108	149.668	491	12.869
Gjirokastër	217.422	85.878	395	19.154
Korçë	81.294	12.610	155	24.475
Kukës	130.258	49.573	381	11.303
Lezhë	68.020	33.860	498	5.387
Shkodër	210.168	60.286	287	6.240
Tiranë	842.981	492.890	585	16.213
Vlorë	188.033	72.550	386	83.054

Burimi i informacionit: INSTAT - Vrojtimi vjetor

MBETJE URBANE DHE INERTE SIPAS QARQEVE



Mbetjet e ngurta urbane, janë mbetjet e ngurta familjare dhe mbetjet e tjera të ngjashme me to të cilat vinë nga shërbimet komunitare ndaj popullatës në zonat e banuara qoftë dhe përkohësisht. Statistikat e mbetjeve urbane u referohen të dhënave vjetore të përgjithësuara në nivel vendi për prodhimin e treguesve statistikor standard sipas përcaktimeve në legjislacionin Shqiptar dhe atë Evropian. Treguesit mbi sasinë e mbetjeve për banor i referohen popullsisë rezidente dhe sasisë totale të mbetjeve te menaxhuara me fonde publike nen kujdesin e bashkive ne te gjithë vendin.

Në vitin 2016 rezulton të jenë menaxhuar 1.3 milion tonë mbetje nga 1.4 milion tonë në vitin 2015, duke shënuar një rënie me rreth 8 pikë përqindje. Sasia vjetore e mbetjeve të gjeneruara për banorë në shkallë vendi ka patur luhatje të vazhdueshme, kjo shifër ishte 373 kg/banor në vitin 2016 dhe 396 kg/banor në vitin 2015.

A e dini se?

Sasia e mbetjeve të menaxhuara për banor rezident vitet e fundit ka tendencë në rritje. Shkalla e mbulimit të popullatës me shërbime komunitare për menaxhimin e mbetjeve urbane ka tendencë rritje po ashtu.

Në vitin 2017 plazhet me cilësinë më të mirë të ujrave larës rezultojnë Dhërmi, Himarë dhe Borsh, ku respektivisht 100 % e stacioneve të vrojtuara janë vlerësuar me cilësi të shkëlqyer. Treguesit e cilësisë së ujerave larës në plazhet e Shqipërisë kanë qëndruar përgjithësisht në të njëjtat nivele me cilësi të shkëlqyer ose të mirë në 85 % të tyre.

Të dhënat për cilësinë e ujrave larës në plazhet e Shqipërisë u referohen matjeve të përsëritura në të gjitha plazhet detare. Këto të dhëna i referohen kryesisht përmbajtjes së kolonive të baktereve me origjinë nga shkarkimet në ujërat detare dhe ujërat e brendshme.

A e dini se?

Ndotja e ujit në plazhe dëmton direkt shëndetin e atyre që bëjnë plazh dhe indirekt ekonominë.

MBETJE TË GJENERUARA NË TOTAL NË TON



CILËSIA E UJRAVE LARËS NË PLAZHET E SHQIPËRISË

Stacione* Plazhet	2015	2016	2017
Velipojë	7	7	7
Shëngjin	5	5	5
Durrës	21	21	21
Kavajë	10	9	9
Vlorë	11	10	10
Dhërmi	3	4	4
Himarë	4	5	5
Borsh	3	3	3
Sarandë	6	6	6
Gjiri i Lalzit	3	3	3
Qeparo	2	2	2
Ksamil	3	3	3

CILËSIA E UJRAVE LARËS NË PLAZHET E SHQIPËRISË

Plazhet	Cilësia* 2017			
	A. Cilësi e shkëlqyer	B. Cilësi e mirë	C. Cilësi e mjaftueshme	D. Cilësi e keqe /Masa të menjëherëshme
Velipojë	4	3	0	0
Shëngjin	3	2	:	:
Durrës	1	7	4	9
Kavajë	3	3	3	0
Vlorë	5	1	0	4
Dhërmi	4	0	0	0
Himarë	5	0	0	0
Borsh	3	0	0	0
Sarandë	3	2	0	1
Gjiri i Lalzit	3	0	0	0
Qeparo	2	0	0	0
Ksamil	3	0	0	0

* Shënim: Numri i stacioneve të monitoruara në plazhe
* Cilësia shpreh shkallën në përqindje e plotësimit të standardeve cilësore sipas OBSH në plazhet përkatëse
Burimi i informacionit: Ministria e Mjedisit

PESHKIMI SIPAS KATEGORIVE UJORE

	Në ton		
Kategoritë	2015	2016	2017
Gjithsej zënie	**5.359**	**5.274**	**5.420**
Detar	2.396	2.830	2.553
Bregdeti	291	580	595
Laguna	261	364	332
Ujërat e brendshme	1.180	594	460
Akuakultura	936	604	1.050
Molusqe	295	302	430

MBETJE URBANE DHE INERTE SIPAS QARQEVE



PESHKIMI SIPAS KATEGORIVE UJORE



Peshkimi përfshin të gjitha të dhënat e aktivitetit të flotës dhe kapacitetin prodhues të sipërfaqeve të ndryshme të peshkimit. Aktivitet peshkimi: janë veprimtaritë e lidhura me kërkimin e peshkut, me lëshimin, vendosjen dhe tërheqjen e mjeteve të peshkimit, transferimin në bord të zënieve, trasbordimin, ruajtjen në bord, transformimin në bord, transferimin, vendosjen në kosha, majmërinë dhe shkarkimin e peshqve dhe produkteve të peshkimit.

Ujëra të brendshme; janë lagunat bregdetare, liqenet natyrore, liqenet e hidrocentraleve, ujëmbledhësit e bujqësisë, lumenjtë dhe ujëra të tjera të Republikës së Shqipërisë, të ndryshme nga ujërat detare

Peshkimi detar gjatë vitit 2017 ka patur nje rënie me 10 % krahasuar me vitin 2016. Sektori i Akuakulturës është rritur me ritme të shpejta si një sektor i ri i krijuar në vitin 2000. Në fund të vitit 2017 u kultivuan në rezervate dhe vaska të ndryshme të specializuara rreth 1.050 ton peshk ose 73 % më shumë krahasuar me vitin 2016. Kjo sasi zë 19,4 % të prodhimit total të peshkut, mbas atij detar me 47,1 %.

Zonat e mbrojtura

"Zona të mbrojtura" shpallen territore tokësore, ujore, detare e bregdetare të caktuara për mbrojtjen e diversitetit biologjik, të pasurive natyrore dhe kulturore, bashkëshoqëruese, të cilat menaxhohen me rrugë ligjore dhe me metoda shkencore bashkëkohore. Zonat e mbrojtura ndahen në 6 kategori të cilat janë: Park kombëtar, Monument natyror, Rezervat natyror i menaxhuar, Peisazhi i mbrojtur, Zonë e mbrojtur e burimeve të menaxhuara. Në vitet e fundit vihet re se në zonat e mbrojtura nuk ka ndryshim në siperfaqe apo në numrin e tyre.

RRJETI I ZONAVE TË MBROJTURA

	Numri i zonave të mbrojtura (nr)			Sipërfaqja e zonave të mbrojtura (ha)		
	2015	2016	2017	2015	2016	2017
Gjithsej	**800**	**800**	**800**	**477.566**	**477.566**	**477.566**
Rezervë natyrore,shkencore	2	2	2	4.800	4.800	4.800
Parqe Kombëtare	15	15	15	210.501	210.501	210.501
Monument natyre	750	750	750	3.470	3.470	3.470
Rezervë Natyrore e Menaxhuar	24	24	24	144.685	144.685	144.685
Peisazh i mbrojtur (tokë,det,ujë)	5	5	5	95.864	95.864	95.864
Rezervë e Burimeve të Mbrojtura	4	4	4	18.245	18.245	18.245

NUMRI I ZONAVE TË MBROJTURA / NR



SIPËRFAQJA E ZONAVE TË MBROJTURA / HA



A e dini se?

Në 2018 u realizua censusi I shpendëve dimërorë të ujit, I cili numëron 139 mijë shpendë dimërorë të ujit, që popullojnë 21 ligatinat shqiptare

FONDI PYJOR SIPAS PRONËSISË

	Sip.Ha			Volumi 000m3		
	2015	2016	2017	2015	2016	2017
Pyje gjithsej	**1.052.253**	**1.052.237**	**1.051.871**	**55.247**	**55.185**	**54.925**
Pyje publikë	1.023.473	1.023.457	1.023.091	51.953	51.891	51.631
Pyje privatë	28.780	28.780	28.780	3.294	3.294	3.294

Burimi I informacionit: Ministria e Mjedisit

FONDI PYJOR SIPAS PRONËSISË (SIPËRFAQJA HA)



FONDI PYJOR SIPAS PRONËSISË (VOLUMI M3)



Pyjet

Në fondin pyjor sipas pronësise 97.3 % e sipërfaqes e zenë pyjet publike dhe 2.7 % ato private. Për sa i perket volumit të lëndës drusore 94% përbëhet nga pyjet publike dhe 6% nga pyjet private. Në vitin e fundit, vihet re një rënie e lehtë në siperfaqen e pyjeve dhe volumin e fondit pyjor, si pasojë e zjarreve në pyje dhe shfrytëzimit për dru zjarri për nevojat e popullsisë në zonat rurale.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit gjatë vitit 2018 do të kryejë Inventarin Kombëtar të Pyjeve nën derjtimin e Agjensisë Kombëtare të Mjedisit, nën udhëheqjen e Agjensisë së Pyjeve të Suedisë dhe Fakultetit të Shkencave Pyjore Suedeze.

A e dini se?

Fondit pyjor në Pukë i shtohen 16 mijë fidanë të rinj gështenjash.

TRANSPORTI

Në vitin 2017 krahasuar me vitin 2016, numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat detare është rritur me 16,9 %: i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat ajrore me 19,8 % dhe numri i pasagjerëve që udhëtojnë me linjat hekurudhore është ulur 25,6 %.

Numri i pasagjerëve që udhëtojnë me ajër në vitin 2017, zë mesatarisht 62,6 % të numrit të pasagjerëve gjithsej që udhëtojne (me det, ajër dhe hekurudhë) i ndjekur nga numri i pasagjerëve që udhëtojnë me det me 35,9 % dhe i pasagjerëve që udhëtojnë me hekurudhë me 1,6 %.

Në vitin 2017 mallrat e transportura nëpërmjet detit zënë rreth 62,8 % të eksporteve shqiptare dhe rreth 48,6 % të importeve shqiptare.

LËVIZJA E MALLRAVE SIPAS MËNYRËS SË TRANSPORTIT 2017

	Eksportet		Importet	
	milion lekë	% ndaj gjithsej	milion lekë	% ndaj gjithsej
Gjithsej	272.988	100,0	626.179	100,0
Transporti detar	171.468	62,8	304.255	48,6
Transporti rrugor	97.812	35,8	279.540	44,6
Transporti ajror	1.300	0,5	17.868	2,9
Mënyra të tjera transporti	2.408	0,9	24.516	3,9

NUMRI I PASAGJERËVE QË UDHËTOJNË ME MJETE TË TRANSPORTIT DETAR, AJROR DHE HEKURUDHOR



A e dini se?

Rreth 52,9 % e volumit tregtar të mallrave në vitin 2017 janë transportuar me det, ndërsa numri i pasagjerëve që udhëtojnë me ajër zë më shumë se gjysma e numrit të pasagjerëve gjithsej (62,6 %).

HYRJET E JO -RESIDENTËVE NË PIKAT KUFITARE KOMBËTARE SIPAS KOMBËSISË

	2015	2016	2017
Gjithsej	**4,131,242**	**4,735,511**	**5,117,700**
I . Afrika	2,973	1,077	2,080
II. Amerika	96,763	103,839	123,729
III.Azia Lindore dhe Paqësori	33,032	35,894	53,533
IV.Lindja e Mesme	3,604	4,324	4,722
V. Azia e Jugut	1,636	1,699	2,216
VI. Evropa	3,759,423	4,485,405	4,686,695
Evropa Qëndrore / Lindore	151,457	182,581	269,261
- Evropa Veriore	125,513	149,965	204,099
- Evropa Jugore	3,169,174	3,855,617	3,810,337
- Evropa Perëndimore	246,811	221,492	316,120
- Evropa Lindore / Mesdheut	66,468	75,750	86,878
VII. Rajone të paspecifikuara	233,811	103,273	244,725

DALJET E SHTETASVE SHQIPTARË DHE HYRJET E SHTETASVE TË HUAJ NË PIKAT KUFITARE KOMBËTARE



Hyrjet e shtetasve të huaj në pikat kufitare për vitin 2017 janë rritur me 8,1 % ndërkaq daljet e shtetasve shqiptarë janë rritur me 6,9 % krahasuar me vitin 2016.

Gjatë vitit 2017, hyrjet e shtetasve të huaj nga rajoni i Evropës zënë peshën më të madhe të hyrjve të shtetasve të huaj gjithsej me 91,6 %.

Evropa jugore zë përqindjën më të lartë të hyrjeve të shtetasve të huaj me 81,5 % të hyrjve gjithsej nga Evropa. Hyrjet nga Kosova zënë 45,8 % të hyrjve të Evropës Jugore, te ndjekura nga Maqedonia me 17,6 % dhe Mali i Zi me 10,0 %.

Hyrjet e shtetasve të huaj nga rajonet e tjera zëne mesatarisht 8,4 % të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej.

HYRJET E SHTETASVE, është një koncept që i referohet të gjitha hyrjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re. Jo rezident konsiderohet ai person që nuk ka banuar në vëndin e vizituar për më shumë se 12 muaj radhazi përpara mbërritjes së tij në vendin e vizituar.

A e dini se?

Hyrjet e shtetasve të huaj gjatë vitit 2017nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi zënë mesatarisht 54.7 % të hyrjeve të shtetasve të huaj gjithsej.

INSTAT